



Aneks Nr. 1

MBI PARSG: Pyetja 1

Zbatimi i rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për të përmirësuar zbatimin e ligjit për shërbimin civil në nivel vendor

Për periudhën **janar – dhjetor 2024**, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes në vazhdim (*pra, verifikimin e zbatimit të vendimeve paralajmëruese pas përfundimit të afatit të paralajmërimit*), rezulton se gjatë periudhës raportuese ky proces është zhvilluar për **19 vendime** (që përmbajnë rekomandime/detyra të shumta) që u përkasin njësisë të vetëqeverisjes vendore – **18 bashki dhe 1 këshill qarku**, të nxjerra në përfundim të proceseve të mbikëqyrjes, inspektimit ose hetimit administrativ (*përfshirë vendimet e nxjerra para periudhës raportuese*).

Sipas ecuresë së tij, procesi i mbikëqyrjes në vazhdim është përmbyllur për 9 vendime paralajmëruese, nga të cilat:

≡ **7 vendime** janë zbatuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Komisioneri (**6 bashki dhe 1 këshill qarku**);

≡ **2 vendime** janë përmbyllur për shkak të pamundësisë objektive, pasi objekti i tyre nuk ekziston më.

Për **10 vendime**, procesi është shtyrë për në vitin 2025, për shkak të kompleksitetit të çështjeve të përfshira. Këto çështje lidhen kryesisht me procesin e rekrutimit në shërbimin civil, duke konsistuar sidomos në një numër të lartë emërimesh të kryera në kundërshtim me ligjin, të cilat kërkojnë një kohë relativisht të gjatë për përfundimin e proceseve; ato lidhen gjithashtu me rivlerësimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, një proces kompleks që kërkon përgatitje teknike specifike që institucionet e administratës së qeverisjes vendore shpesh nuk e kanë (*në raste të tilla është kërkuar asistencë*

teknike nga këto subjekte); si edhe me mungesën e kandidatëve të përshtatshëm si nga pikëpamja cilësore ashtu edhe nga niveli arsimor. Ndërkohë, në disa raste, afati për zbatimin e tyre përkon me fundin e vitit 2024.

Sa i përket vitit 2025 (**janar – gusht 2025**), situata paraqitet si vijon:

Gjatë kësaj periudhe, Komisioneri ka vijuar procesin e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimeve paralajmëruese për **17** raste, që u përkasin njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Rezultoni se detyrimet e ngarkuara janë përmbyllur nga **4 njësi të vetëqeverisjes vendore**.

Për shkak të kompleksitetit të procedurave që duhet të ndiqen në rastet e rekrutimit, si edhe për shkak të përkimit kohor me periudhën zgjedhore, e cila solli pezullimin e rekrutimeve, Komisioneri ka marrë masat e mëposhtme për të garantuar zbatimin e vendimeve të tij:

≡ Gjatë muajit qershor, Komisioneri zhvilloi seanca dëgjimore për 5 vendime paralajmëruese të mbartura nga viti 2024, me përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore (konkretisht bashkitë Gramsh, Peqin, Belsh, Prenjas dhe Librazhd).

≡ Njëkohësisht, gjatë periudhës korrik – gusht 2025, procesi i mbikëqyrjes në vazhdim vijoi për 6 vendime të tjera paralajmëruese përmes inspektimeve në terren pranë subjekteve përkatëse. Gjatë këtij procesi, u vu re një

angazhim serioz nga njësitë vendore për ta sjellë situatën në kuadrin e ligjshmërisë. Konkretisht, u konstatua se disa prej tyre i kishin zbatuar plotësisht detyrat e ngarkuara (si Bashkia Cërrik dhe Bashkia Kurbin), ndërsa të tjerat i kishin zbatuar pjesërisht dhe shprehën gatishmërinë për të marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Për këtë arsye, një pasqyrë më e plotë e situatës do të paraqitet në raportin vijues.

≡ Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në vendime, Komisioneri ka vijuar komunikimin institucional me subjektet përkatëse për të kërkuar informacion lidhur me masat që ato kanë marrë.

Objekti i detyrave të ngarkuara në vendimet paralajmëruese të nxjerra nga Komisioneri për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat e qarqeve) ka qenë si më poshtë:

≡ Nxjerrja e aktit të emërimit në rastin e pezullimit, të konkurrimit ose të përfundimit të periudhës së provës.

≡ Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit për largimin nga puna të nëpunësit civil dhe rikthimi i tij në pozicionin e mëparshëm.

≡ Shfuqizimi i masës disiplinore “Vërejtje” për punonjësin dhe monitorimi i ecurisë së procesit administrativ, duke hequr masën disiplinore nga dosja personale e punonjësit dhe Regjistri Qendror i Personelit.

≡ Nxjerrja e aktit të lirimit nga shërbimi civil për shkak të plotësimit të moshës së pensionit.

≡ Shfuqizimi i vendimit për transferimin e përhershëm të punonjësit dhe lirimi i tij nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.

≡ Anulimi i aktit të transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil dhe rikthimi i tij në pozicionin e mëparshëm.

≡ Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit në pozicione të shërbimit civil, të kryer në kundërshtim me ligjin, për shkak të moszhvillimit të procesit të konkurrimit.

≡ Rishikimi i përshkrimeve të punës dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta brenda përmbajtjes së përshkrimit të punës lidhur me përvojën në punë, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim eliminimin e subjektivizmit në zbatimin e këtij kriteri në një rast konkurrimi.

≡ Hartimi dhe miratimi i planit vjetor të rekrutimit.

≡ Hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil.

≡ Rivlerësimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

≡ Krijimi i Komisionit për Vlerësimin dhe Klasifikimin e Pozicioneve të Punës në Shërbimin Civil.

≡ Përfundimi i procedurës për konfirmimin e nëpunësit civil pas periudhës së provës.

≡ Administrimi dhe plotësimi i dosjeve të personelit.

≡ Shfuqizimi i procedurës së konkurrimit/ngritjes në detyrë/transferimit lëvizjes paralele/procedurës disiplinore për shkak të mosrespektimit të ligjit material dhe procedurës së kërkuar nga ligji.

≡ Planifikimi i trajnimeve në bashkëpunim me ASPA.

≡ Garantimi i ligjshmërisë në plotësimin e formularit të vlerësimit të punës me komente në të gjitha rubrikat e tij nga zyrtarët vlerësues, në rolin e Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues dhe Zyrtarit Autorizues.

≡ Krijimi i Komisionit të Përhershëm të Pranimit në Shërbimin Civil për çdo vit kalendarik.

Gjatë ushtrimit të detyrave të tij sipas ligjit, Komisioneri ka vërejtur një përmirësim të ndjeshëm në zbatimin e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, veçanërisht në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, me një ndërgjegjësim dhe njohje më të madhe të rëndësisë së respektimit të kuadrit ligjor që rregullon shërbimin civil. Zbatimi i detyrave të ngarkuara nga Komisioneri ka ndikuar pozitivisht në rritjen e respektimit të ligjshmërisë dhe në përmirësimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, si në proceset e rekrutimit ashtu edhe në vlerësimin e performancës dhe zhvillimin e karrierës, si dhe në disiplinën në shërbimin civil dhe aspekte të tjera të lidhura me të.

Megjithatë, sfidat vazhdojnë të ekzistojnë, kryesisht në lidhje me proceset e emërimit në kundërshtim me ligjin në disa njësi të tjera vendore. Këto problematika lindin për shkak të kompleksitetit të procedurave, mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme për ta kuptuar dhe zbatuar siç duhet ligjin, si edhe problemeve që lidhen me vullnetin politik të drejtuesve të këtyre institucioneve, siç do të shtjellohet më poshtë.

Zbatimi i vendimeve të Komisionerit, në përputhje me pikën 2 të nenit 15 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe interpretimi që ky ligj i jep termit “zyrtar përgjegjës”, në rastet e përgjegjësisë për moszbatimin e vendimit.

Duke njohur të drejtën e Komisionerit për t’u tërhequr vëmendjen

institucioneve kur evidentohen shkelje të ligjit dhe për të vendosur detyrime konkrete për rregullimin e situatës, pika 2 e nenit 15 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon gjithashtu mundësinë që Komisioneri të vendosë sanksione ndaj “nëpunësit civil përgjegjës” për moszbatimin e detyrimeve të ngarkuara, në përputhje me masat e parashikuara në këtë dispozitë.

Në praktikë, shpesh ndodh që personi realisht përgjegjës, në rastet e moszbatimit të vendimit të Komisionerit dhe të mosmarrjes së masave të urdhëruara, të mos jetë nëpunësi civil apo drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore, por vetë titullari i institucionit.

Në këtë pikë lind një pengesë ligjore (veçanërisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, anëtarët ose kryetarët e organeve kolegjiale drejtuese të komiteteve ose institucioneve në varësi të Kryeministrit ose një ministri), pasi kur një pretendim i tillë ngrihet nga nëpunësi civil drejtpërdrejt përgjegjës për burimet njerëzore, bëhet e pamundur të procedohet më tej.

Kjo vjen për faktin se, sipas nenit 2 të Ligjit për nëpunësin civil, ky ligj nuk zbatohet për funksionarët e zgjedhur (shkronja “a”); anëtarët ose kryetarët e organeve kolegjiale drejtuese të komiteteve ose institucioneve në varësi të Kryeministrit ose një ministri (shkronja “f”); funksionarët e kabinetit (shkronja “gj”), etj.

Në praktikën e Komisionerit, ka pasur raste të shumta në të cilat është kërkuar anulimi i akteve administrative të largimit nga puna për arsye të ndryshme, ku drejtues të njësisë të vetëqeverisjes

vendore, duke tejkaluar kompetencat e tyre, kanë nxjerrë akte për ndryshime ose ndërprerje të marrëdhënieve të punësimit për arsye të ndryshme, duke anashkaluar autoritetin e Komisionit të Disiplinës, Komisionit të Ristrukturimit etj.

Ne vlerësojmë se, për të parandaluar raste të tilla, do të ishte e përshtatshme të ndryshohej pika 2 e nenit 15 të Ligjit nr. 152/2013 duke përcaktuar saktësisht dhe zgjeruar fushën e konceptit të “nëpunësit civil përgjegjës”, duke hequr kufizimin e përgjegjësisë për drejtuesit e njësisive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura etj., të cilët në shumicën e rasteve ndërhyjnë në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke tejkaluar dhe marrë kompetencat e organeve të tjera të ngarkuara nga ligji.

Për të përmirësuar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, Komisioneri do të rrisë

MBIPARSG:Pyetja2

Zbatimi i vendimeve për largimet e paligjshme nga puna

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Komisioneri, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij procesi — i cili konsiderohet faza përfundimtare në realizimin e një të drejte të fituar gjyqësisht nga një nëpunës civil — prej disa vitesh ka monitoruar institucionet e administratës publike që janë pjesë e shërbimit civil, duke i kategorizuar sipas tipologjisë së institucioneve.

Mbikëqyrja në institucionet e administratës shtetërore

Gjatë vitit **2024**, me Vendimin nr. 31, datë 25.04.2024, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e

numrin e mbikëqyrjeve në institucionet e identifikuara si problematike, do të vazhdojë bashkëpunimin me Shkollën e Administratës Publike për të rritur pjesëmarrjen e administratës vendore në trajnime specifike për ligjin në fjalë, si dhe do të zhvillojë kurrikula të specializuara për këtë kategori institucionesh, ashtu siç është bërë gjatë periudhës raportuese.

Po ashtu, për të përmirësuar nivelin e zbatimit të ligjit në administratën vendore, Komisioneri ka nisur një bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Ministrave, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, duke dhënë përditësime të shpeshta lidhur me gjendjen e administrimit të shërbimit civil në bashkitë e vendit, me synimin për të mbështetur institucionet në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore”, Komisioneri zhvilloi mbikëqyrje të orientuar për periudhën **03.01.2023 – 31.12.2024**, duke përfshirë të gjitha institucionet e administratës shtetërore, përfshirë Kryeministrinë, **11** ministri të linjës dhe **104** institucione të varësisë.

Përmes kësaj mbikëqyrjeje, synimi ishte krijimi i një panorame të plotë të mënyrës se si janë kuptuar dhe zbatuar neni 66/1 i Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe legjislacioni përkatës nënligjor që rregullon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për

rikthimin në punë të nëpunësve civil gjyqfitues.

Sipas raportimeve të paraqitura nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve të mbikëqyrura, numri total i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të paekzekutuara deri në fund të vitit 2024 ishte 134 raste. Pasi Raporti i Vlerësimit iu komunikua Departamentit të Administratës Publike (si njësia përgjegjëse për administratën shtetërore), institucioni na informoi se, deri më 31 dhjetor 2024, ishin kryer edhe **10 emërime** të tjera të nëpunësve civilë gjyqfitues, duke e ulur numrin e nëpunësve civilë në listën e pritjes në **124**.

Për periudhën nga 03 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2024, institucionet e administratës shtetërore raportuan ekzekutimin e **55 vendimeve gjyqësore të formës së prerë** (*duke përfshirë si emërimet e nëpunësve civilë ashtu edhe pagesën e detyrimeve financiare të prapambetura*). Pas komunikimit me institucionet dhe DAP-in, u konfirmua se **35 nëpunës civilë** ishin emëruar në një pozicion të rregullt në shërbimin civil gjatë kësaj periudhe.

E konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë faktin se, për periudhën 2023-2024, nga **116** institucionet e administratës shtetërore të mbikëqyrura, **18 prej tyre** kishin detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë, përfshirë **10 ministri dhe 8 institucione të varësisë**, ndërsa **98 institucionet** e mbetura raportuan se nuk kishin vendime gjyqësore për të ekzekutuar.

Përmes Raportit të Vlerësimit të miratuar me Vendimin nr. 88, datë 20.12.2024, të

nxjerrë nga Komisioneri dhe të publikuar në faqen zyrtare të institucionit, institucioneve të administratës shtetërore u është rekomanduar të veprojnë në përputhje me ligjin duke respektuar një afat të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në këtë kontekst, Komisioneri ka kërkuar që institucionet shtetërore të krijojnë mekanizma të brendshëm, si Komisioni i Posaçëm, sipas Urdhrit nr.5151, datë 28.10.2015, “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore subjekt i ligjit për shërbimin civil”. Funksionimi i këtij komisioni mundëson zbatimin e shpejtë dhe efektiv të vendimeve gjyqësore, duke minimizuar hapësirën për interpretime të paqarta apo vonesa të panevojshme. Çdo vonesë e panevojshme në ekzekutim është e papranueshme, pasi jo vetëm cenon të drejtat e nëpunësit civil, por sjell edhe pasoja ligjore dhe financiare për institucionet/subjektet përgjegjëse.

Në këtë drejtim, përmbushja e plotë e detyrimit i shërben jo vetëm kreditorit në ushtrimin e së drejtës së tij të dhënë me vendim gjyqësor, por kontribuon gjithashtu në menaxhimin më të mirë të buxhetit të shtetit, pasi prej vitesh u paguhen paga punonjësve në listën e pritjes pa punuar asnjë ditë.

Për të mbështetur rritjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore, Komisioneri ka marrë pjesë edhe në mbledhjet e Komisionit të Posaçëm, të zhvilluara brenda institucioneve të ndryshme të administratës shtetërore.

Mbikëqyrja në institucionet e vetëqeverisjes vendore

Me Vendimin nr. 22, datë 21.05.2025, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Komisioneri ka filluar mbledhjen e informacionit në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civil gjyqfites në një pozicion të rregullt brenda shërbimit civil, në institucionet e vetëqeverisjes vendore, të cilat përfshijnë 61 bashki dhe 12 këshilla qarku.

Kjo mbikëqyrje e orientuar është ende në vijim; megjithatë, deri në këtë moment, nga **73** njësi të vetëqeverisjes vendore (61 bashki dhe 12 këshilla qarku), **51 institucione** kanë paraqitur raportet e tyre.

Sipas raportimeve të njërive të menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve të mbikëqyrura, numri total i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të detyrueshme të pazbatuara arrin në **95** raste. Prej tyre, 9 vendime gjyqësore të formës së prerë dhe të detyrueshme janë ekzekutuar përmes rikthimit në shërbimin civil, ndërsa **86** nëpunës civilë mbeten në listën e pritjes.

Komisioneri vijon ta konsiderojë këtë proces prioritar duke orientuar institucionet lidhur me procedurën që duhet të ndjekin për të garantuar ekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

3. Vështirësi në zbatim

A ka raste kur institucionet refuzojnë të zbatojnë vendimet?

Probleme me mungesën e fondeve për dëmshpërblim apo mungesën e vendeve të punës për rikthim?

Komisioneri e konsideron problematike situatën lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në punë të nëpunësve civilë gjyqfites. Megjithatë, nga ana tjetër, vihet re një rritje e dukshme e reagimit institucional për të zgjidhur këtë problematikë të kahershme, siç dëshmohet nga reagimi pozitiv në dorëzimin në kohë të të dhënave të kërkuara; nga kërkesat për sqarim mbi çështjet që lindin gjatë zbatimit të vendimeve gjyqësore; si dhe nga fillimi i planifikimit të pagesave për shlyerjen e detyrimeve financiare si një zë i veçantë buxhetor brenda institucioneve.

Komisioneri vlerëson se situata e krijuar nuk ka ardhur vetëm për arsye subjektive që lidhen me mungesën e vullnetit të institucioneve për të zbatuar vendimet gjyqësore. Pengesa me natyrë financiare dhe tekniko-ligjore vazhdojnë të ekzistojnë, të shkaktuara nga mangësi dhe paqartësi në dispozita të caktuara të ligjeve që zbatohen gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto dispozita kërkojnë rishikim dhe plotësim për të lehtësuar ecurinë normale të procesit dhe për të parandaluar mundësitë për interpretime subjektive.

Në këto raste, Komisioneri e ka trajtuar gjerësisht çështjen në raportet vjetore ndër vite. Shpesh ndodh që institucionet t’u drejtohen sërish gjykatave për të kërkuar një vendim mbi mënyrën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për shkak të arsyeve të përmendura më sipër.

Për këtë arsye, Komisioneri e ka konsideruar të nevojshme të orientojë institucionet lidhur me masat që duhet të marrin për të kryer procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të

formës së prerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me qëllim unifikimin e këtij procesi në të gjitha institucionet e administratës publike dhe garantimin e transparencës së tij, është e nevojshme që institucionet t'u përmbahen disa hapave proceduralë, duke ndjekur këtë rend veprimesh:

≡ Krijimi i Komisionit të Posaçëm. Ky mekanizëm drejtohet nga nëpunësi civil me rangun më të lartë të institucionit, dhe anëtarët e tij përfshijnë përfaqësues nga njësitë përgjegjëse për çështjet ligjore, ato financiare/buxhetore dhe burimet njerëzore. Komisioni e fillon punën duke identifikuar të gjitha kërkesat e kreditorëve ose të përmbauesve gjyqësorë, duke krijuar një bazë të dhënash që përmban informacion mbi çështjet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë dhe janë të detyrueshme për zbatim. Për secilin proces gjyqësor administrohen të gjitha aktet administrative, duke filluar nga akti i largimit ose ndërprerjes, deri te kërkesat dhe urdhrat e nxjerra nga kreditori ose përmbauesi gjyqësor. Komisioni regjistron gjithashtu faktet dhe rrethanat që lidhen me pozicionin e punës të mbajtur nga nëpunësi civil në kohën e largimit, si edhe statusin e tij ligjor pas nxjerrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna përditësohen rast pas rasti, në varësi të veprimeve administrative, deri në ekzekutimin përfundimtar të vendimit gjyqësor.

≡ Komisioni identifikon gjithashtu detyrimet monetare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, me qëllim planifikimin e burimeve të nevojshme financiare për shlyerjen e shumave përkatëse. Shuma totale e detyrimeve që lidhen me ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore të formës së

prerë bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor për vitin fiskal pasardhës, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

≡ Komisioni analizon situatën dhe propozon shlyerjen e detyrimeve duke respektuar rendin e paraqitjes së titujve ekzekutivë në institucion, si edhe duke marrë masa për të siguruar pagesën e tyre brenda vitit fiskal pasardhës. Ky proces duhet të kryhet në mënyrë transparente, duke publikuar kalendarin e shlyerjes në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse;

≡ Komisioni shqyrton mundësinë e vendosjes së nëpunësit civil të rikthyer në pozicionin që mbante para largimit ose në një pozicion të barasvlershëm dhe nxjerr një akt rekomandues për zgjidhjen konkrete të situatës.

Njësia Përgjegjëse, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit, vendos për emërimin e nëpunësit civil nëse është e mundur të vendoset në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion pune të barasvlershëm. Në rast se nuk ka pozicione vakante brenda së njëjtës kategori, nëpunësit civil i propozohet një pozicion në një kategori më të ulët, por në këtë rast duhet të merret miratimi i tij paraprak.

Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Komisionerin, ka punuar për paraqitjen në Kuvend të një projekt-ndryshimi të dispozitës që rregullon këtë aspekt të Ligjit për Shërbimin Civil, me qëllim mundësimin e ecurisë normale të procesit për rikthimin në shërbimin civil të nëpunësve gjyqësorë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në përputhje me nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013, "Për

nëpunësin civil” (shtuar me Ligjin nr. 178/2014) – Kjo dispozitë konsiderohet nga Komisioneri se ka qenë e menduar si e përkohshme, e zbatueshme vetëm për ato vendime që kishin mbetur të paekzekutuara nga vitet e mëparshme dhe që kishin rritur barrën e detyrimeve financiare mbi buxhetin e shtetit.

Ky përfundim arrihet sepse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një institut i rregulluar gjerësisht nga kapitujt përkatës të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nuk ka nevojë që një dispozitë specifike e kësaj natyre të ekzistojë veçmas brenda një ligji të posaçëm, siç është ligji që rregullon marrëdhëniet në shërbimin civil.

Ky konstatim vlen në përgjithësi për rastin, por në veçanti vështirësi janë hasur në zbatimin e kësaj dispozite, konkretisht pika 4 e nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e cila parashikon:

“Njësia përgjegjëse është e detyruar, në momentin që krijohet një vend vakant në shërbimin civil, të emërojë, së pari, me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listën e pritjes, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës.”

Vështirësia dhe keqkuptimi i hasur në praktikë në zbatimin e kësaj dispozite lidhen me faktin se, për ekzekutimin e vendimeve të tilla gjyqësore, kërkohet detyrimisht pëlqimi (pa kufizim) i nëpunësit civil gjyqfitues. Në shumë raste, nëpunës të ndryshëm civilë të regjistruar në listën e pritjes sipas pikës 2 të kësaj dispozite kanë refuzuar në

mënyrë këmbëngulëse të fillojnë punë në një pozicion të ofruar, duke pretenduar se duhet të rikthehen në pozicionin e tyre të mëparshëm, edhe pse ky pozicion mund të jetë suprimuar ose ristrukturuar dhe, objektivisht, ekzekutimi i vendimit në atë mënyrë është i pamundur.

Duke spekuluar mbi përmbajtjen e dispozitës në fjalë, e cila urdhëron pagesën e pagës sipas pozicionit të fundit të mbajtur në shërbimin civil deri në momentin e emërimit, ata refuzojnë të transferohen në një pozicion të barasvlershëm brenda së njëjtës kategori, duke vijuar të marrin pagë në mënyrë të paligjshme.

Nga ana tjetër, edhe në raste të tilla të ngjashme, linden vështirësi në sistemimin e nëpunësve civilë gjyqfitues, veçanërisht në institucionet e pavarura dhe organet e qeverisjes vendore, për shkak të mungesës së një mekanizmi koordinues ndërmjet tyre dhe numrit të kufizuar të pozicioneve të disponueshme në përgjithësi, e veçanërisht të pozicioneve vakante.

Për të rregulluar situatën dhe për të parandaluar përsëritjen e rrethanave të tilla të padëshiruara që dëmtojnë buxhetin e shtetit, Komisioneri vlerëson se duhet të merren masat e mëposhtme:

≡ Dispozita që lidhet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (pika 4, neni 66/1 i ligjit përkatës) duhet të ndryshohet për të hequr nocionin e “marrjes së pëlqimit të nëpunësit civil” për emërimin, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, në një pozicion tjetër brenda shërbimit civil, duke theksuar në vend të kësaj detyrimin e institucionit për të ruajtur kategorinë përkatëse dhe kriteret e pozicionit të punës; ose

≡ Pëlqimi i dhënë nga nëpunësi civil nuk duhet të jetë i pakushtëzuar, por duhet t'u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në nenet 50, 51, 52 etj., të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si: e njëjta kategori, arsye shëndetësore, largësia nga vendbanimi, konflikti i interesit etj.

Kjo dispozitë duhet të përcaktojë qartë mënyrën e veprimit në rastet kur nëpunësit civilë që kanë kërkuar

MBI PARSG: Pyetja 3

Të dhëna mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit të Avokatit të Popullit dhe të raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitet 2023-2024 dhe institucioneve të tjera të pavarura

Për periudhën **janar – dhjetor 2024**, Komisioneri përmbylli, me vendim, **47 procese mbikëqyrjeje/inspektimi ose hetimi administrativ**¹, nga të cilat:

≡ **7** procese të mbikëqyrjes së orientuar, të cilat kanë natyrë informuese dhe synojnë njohjen e situatës (*këto procese shtrihen gjatë gjithë vitit brenda një tipologjie të caktuar institucionesh ose në të gjitha institucionet që mbulohen nga fusha e zbatimit të ligjit "Për nëpunësin civil", lidhur me një ose të gjitha dispozitat ligjore, ose në disa raste, për një periudhë të caktuar, si për shembull periudha e fushatës zgjedhore*). Këto procese janë përmbyllur me **vendime që miratojnë raportin e vlerësimit të situatës**, i cili përgatitet për raste të tilla, duke dhënë orientime për aspekte të veçanta dhe duke i shërbyer njëkohësisht Komisionerit në planifikimin e veprimtarisë së tij.

ekzekutimin e një vendimi gjyqësor për t'u rikthyer në punë në shërbimin civil kanë filluar ndërkohë, me vullnetin e tyre, punë në institucione jashtë shërbimit civil ose në sektorin privat. Aktualisht, në raste të tilla, ndërsa këta punonjës marrin pagë nga një institucion tjetër ku janë të punësuar, ata vazhdojnë të kërkojnë pagesën e pagës mbi bazën e vendimit gjyqësor, edhe në këto rrethana.

≡ **14** procese mbikëqyrjeje/inspektimi ose hetimi administrativ, në të cilat nuk u konstatuan shkelje gjatë administrimit të shërbimit. Në këto rrethana, Komisioneri nuk nxori vendim paralajmërues, duke e mbyllur procesin në këtë fazë.

≡ **26** procese mbikëqyrjeje/inspektimi ose hetimi **administrativ u përmbyllën me vendime paralajmëruese**, me synim rikthimin e ligjshmërisë (*nga të cilat, në 5 raste, afati i zbatimit shtrihet në vitin 2025*).

Të shprehura në përqindje, rezulton se në **30%** të rasteve të mbikëqyrura nuk janë identifikuar shkelje ligjore, ndërsa **55%** e numrit total të vendimeve të nxjerra në përfundim të procesit mbikëqyrës kanë qenë **vendime paralajmëruese**, ku janë vendosur detyrime konkrete për rivendosjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

¹ Shih Raportin Vjetor të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024, të paraqitur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili mund të aksesohet në lidhjen e

mëposhtme: <https://kmshe.al/wp-content/uploads/2025/09/Raporti-KMSHC-2024.pdf>

Sa i përket procesit të mbikëqyrjes në vazhdim (*pra, verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese pas skadimit të afatit të paralajmërimit*), rezulton se gjatë periudhës raportuese ky proces është zhvilluar për **38** vendime paralajmëruese (nga të cilat **19** vendime u përkasin njësisive të vetëqeverisjes vendore – **18 bashki dhe 1 këshill qarku**), të nxjerra në përfundim të proceseve të mbikëqyrjes, inspektimit ose hetimit administrativ (*përfshirë vendimet e nxjerra para periudhës raportuese*).

Sipas ecurisë së tij, procesi i mbikëqyrjes në vazhdim është përmbyllur për 27 vendime paralajmëruese, nga të cilat:

≡ **22 vendime** janë zbatuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Komisioneri (**7 prej këtyre** vendimeve u përkasin njësisive të vetëqeverisjes vendore – **6 bashki dhe 1 këshill qarku**);

≡ **3 vendime** nuk mund të ndiqeshin për zbatim për shkak të pamundësisë objektive, sepse objekti i tyre nuk ekziston më (**2 prej tyre lidhen me njësitë e vetëqeverisjes vendore – bashki**) ose për shkak të ndryshimit të rrethanave (siç janë rastet kur institucioni ka dalë jashtë fushës së zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”); dhe

≡ **2 vendime** janë përmbyllur sepse çështjet përkatëse janë aktualisht në shqyrtim gjyqësor dhe do të zgjidhen përfundimisht nga gjykata.

Për **11** vendime (**10 prej të cilave u përkasin njësisive të vetëqeverisjes vendore – bashki**), procesi është shtyrë për në vitin 2025 për shkak të kompleksitetit të çështjeve të përfshira. Këto çështje lidhen kryesisht me procesin e rekrutimit në shërbimin civil,

sidomos me një numër të lartë emërimesh të kryera në kundërshtim me ligjin, të cilat kërkojnë një kohë relativisht të gjatë për përfundimin e proceseve; ato lidhen gjithashtu me rivlerësimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, një proces kompleks që kërkon përgatitje teknike specifike që institucionet e administratës së qeverisjes vendore shpesh nuk e kanë (në raste të tilla është kërkuar asistencë teknike nga këto subjekte); si dhe me mungesën e kandidatëve të përshtatshëm si nga pikëpamja cilësore ashtu edhe nga niveli arsimor. Ndërkohë, në disa raste, afati për zbatimin e tyre përkon me fundin e vitit 2024.

Sa i përket vitit 2025 (**janar – gusht 2025**), situata paraqitet si vijon:

Lidhur me vendimet e Komisionerit për vlerësimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, të nxjerra gjatë kësaj periudhe, rezulton se janë përmbyllur me vendim **23** procese mbikëqyrjeje/inspektimi ose hetimi administrativ, nga të cilat: **11** procese janë përmbyllur pa vendime paralajmëruese, pasi nuk u konstatuan shkelje në administrimin e shërbimit civil në institucionet përkatëse; për këtë arsye, procesi u përmbyll pa detyra në këtë fazë. Gjithashtu, **12** procese u përmbyllën me vendime paralajmëruese që synojnë rregullimin e situatës së ligjshmërisë (**nga të cilat 9 vendime u përkasin njësisive të vetëqeverisjes vendore – bashki**).

Gjatë kësaj periudhe, Komisioneri ka vijuar procesin e mbikëqyrjes në vazhdim lidhur me verifikimin e zbatimit të vendimeve paralajmëruese për **24** raste, nga të cilat 11 ishin mbartur nga viti i mëparshëm, ndërsa 5 të tjera u përkasin vendimeve paralajmëruese të

nxjerra gjatë vitit 2024, me afate që përfundonin gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, si dhe **8** vendime paralajmëruese të nxjerra gjatë periudhës raportuese. Nga 24 vendimet që iu nënshtuan procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, **17 u përkasin njësive të vetëqeverisjes vendore.**

Rezulton se detyrimet e ngarkuara janë përmbushur nga **7 institucione**, nga të cilat 4 institucione i përkasin njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për shkak të kompleksitetit të procedurave që duhet të ndiqen në rastet e rekrutimit, si edhe për shkak të përkimit kohor me periudhën zgjedhore, e cila solli pezullimin e rekrutimeve, situata lidhur me **17** vendimet e tjera paraqitet si më poshtë:

≡ Gjatë muajit qershor, Komisioneri zhvilloi seanca dëgjimore për 5 vendime paralajmëruese të mbartura nga viti 2024, ku përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore (konkretisht bashkitë Gramsh, Peqin, Belsh, Prrenjas dhe Librazhd) u thirrën si për t'u dëgjuar ashtu edhe për të marrë asistencë në punën e tyre.

≡ Njëkohësisht, gjatë korrik – gusht 2025, procesi i mbikëqyrjes në vazhdim vijoi për 6 vendime të tjera paralajmëruese përmes verifikimeve në terren pranë subjekteve përkatëse. Gjatë këtij procesi, u vu re një angazhim serioz nga njësitet vendore për ta sjellë situatën në kuadrin e ligjshmërisë. Konkretisht, u konstatua se disa prej tyre i kishin zbatuar plotësisht detyrat e ngarkuara (si Bashkia Cërrik dhe Bashkia Kurbin), ndërsa të tjerat i kishin zbatuar pjesërisht dhe shprehën gatishmërinë për të marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Për

këtë arsye, një pasqyrë më e plotë e situatës do të paraqitet në raportin vijues.

≡ Sa i përket 6 vendimeve paralajmëruese, rezulton se pas skadimit të afateve të përcaktuara në vendime, Komisioneri ka vijuar komunikimin institucional me subjektet përkatëse për të kërkuar informacion lidhur me masat që ato kanë marrë.

Ndërkohë, procesi i verifikimit të ekzekutimit të vendimeve të tjera paralajmëruese është ende në vijim dhe do të shtrihet gjithashtu edhe te vendimet paralajmëruese të nxjerra gjatë vitit 2025, pas përfundimit të afateve të zbatimit të tyre.

Meqenëse objekti i vendimeve paralajmëruese të nxjerra për njësitet e vetëqeverisjes vendore është trajtuar në përgjigje të pyetjes: “Zbatimi i rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për të përmirësuar zbatimin e ligjit për shërbimin civil në nivel vendor”, objekti i vendimeve paralajmëruese që lidhen me institucionet e administratës shtetërore paraqitet më poshtë:

≡ Përshkrimet e punës duhet të jenë të detajuara, në përputhje me legjislacionin, dhe të specifikojnë qartë funksionet e çdo pozicioni.

≡ DAP (Departamenti i Administratës Publike) duhet ta rivlerësojë rastin dhe, nëse identifikohen parregullsi në punësim, të ndërmarrë veprime ligjore për të anuluar aktin e emërimit në shërbimin civil.

≡ Duhet të merren masa për të garantuar respektimin e plotë të kërkesave procedurale gjatë vlerësimit të performancës, siç parashikohet nga ligji.

≡ Vendimi i Komisionit të Disiplinës dhe akti që ndërpret marrëdhënien financiare, i nxjerrë nga

titullari i institucionit, duhet të deklarohen absolutisht të pavlefshëm dhe duhet të garantohet vijimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil të nëpunësit civil.

≡ Anulimi i aktit të largimit nga shërbimi civil.

≡ Anulimi i aktit të vlerësimit të performancës.

≡ Përfundimi i procesit të miratimit ose nënshkrimit të përshkrimeve të

punës për nëpunësit civilë dhe paraqitja e këtyre akteve në DAP.

≡ Përsëritja e procesit të vlerësimit për nëpunësin civil gjatë periudhës së provës dhe anulimi i aktit të largimit.

≡ Anulimi i aktit të vlerësimit dhe përsëritja e procesit të vlerësimit.

≡ Zhvillimi i procesit të vlerësimit të performancës për nëpunësit civilë, përfshirë edhe TND-në (Trupën e Lartë Drejtuese).

MBI PARSG: Pyetja 4

Të dhëna mbi procedurat ankimore të papërfunduara

Megjithëse Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë për zgjidhjen e ankesave/ankimeve të paraqitura nga nëpunësit civilë, bazuar në autoritetin e parashikuar në pikën 1 të nenit 14 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili lejon që mbikëqyrja të ushtrohet kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, Komisioneri ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e të gjitha informacioneve, kërkesave dhe denoncimeve të ndryshme të marra. Duke vepruar kështu, janë dhënë përgjigje konkrete për shqetësimet e ngritura nga subjektet e ligjit dhe nga qytetarët, qoftë drejtpërdrejt, qoftë

përmes vendimeve paralajmëruese drejtuar subjekteve të mbikëqyrura, me qëllim rikthimin e ligjshmërisë.

Në total, **145** raste — që përfshijnë kërkesa, informacione dhe denoncime — iu nënshtruan shqyrtimit në vitin 2024. Prej tyre, **138** u përmbyllën brenda vitit kalendarik, ndërsa vetëm **7** raste u mbartën për shqyrtim në vitin pasardhës.

Tabela e mëposhtme përmbledh klasifikimin e mosmarrëveshjeve administrative të trajtuara gjatë vitit 2024, duke përfshirë si rastet e zgjidhura ashtu edhe ato të mbartura në vitin pasardhës.

Tabela: Klasifikimi i mosmarrëveshjeve administrative sipas objektit për vitin 2024

Institucioni i pretenduar për parregullsi sipas kërkesave/informacioneve	Nr. i rasteve
Procedurat disiplinore	11
Procedura e transferimit ose e largimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit	13
Procedura e transferimit të përkohshëm	7
Procedura e konfirmimit në përfundim të periudhës së provës ose vlerësimet e performancës	7
Procedura e konkurrimit	15
Pezullimi nga shërbimi civil	5
Interpretimi i nenit 65/c lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak të ligjit	23

Të tjera (sqarime mbi interpretimin/zbatimin e saktë të ligjit; parashkrimi i masave disiplinore; transferimi i përkohshëm për nevoja pune; ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe e drejta e nëpunësve civilë për rikthim në shërbimin civil, etj.)	64
TOTAL	145

Lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve administrative për 7 rastet e mbartura, të cilat u trajtuan në fillim të vitit 2025,

situata paraqitet sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Objekti i mosmarrëveshjeve administrative i klasifikuar sipas natyrës së tyre, për rastet e mbartura në vitin 2025

Institucioni i pretenduar për parregullsi sipas kërkesave/informacioneve	Nr. i rasteve
Procedura e largimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit institucional	1
Procedurat disiplinore	3
Procedura e konkurimit	2
Kërkesë për dokumentacion	1
TOTAL	7

Për periudhën raportuese **janar–gusht 2025**, numri total i kërkesave, informacioneve dhe denoncimeve të shqyrtuara deri tani është **68** raste (përfshirë 7 raste të mbartura nga viti i mëparshëm, 2024). Procesi është përmbyllur për **53** raste gjatë periudhës

raportuese, ndërsa verifikimi është ende në vijim për **15** raste.

Duke klasifikuar llojet e mosmarrëveshjeve administrative të trajtuara kryesisht rast pas rasti gjatë vitit 2025, si edhe ato që janë ende në proces, situata paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Mosmarrëveshjet administrative të klasifikuara sipas objektit për vitin 2025

Institucioni i pretenduar për parregullsi sipas kërkesave/informacioneve	Nr. i rasteve
Procedurat disiplinore	10
Procedura për transferim ose largim nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit	5
Procedura për transferim të përkohshëm	3
Procedura e konfirmimit në përfundim të periudhës së provës	2
Procedura e konkurimit	11
Pezullimi nga shërbimi civil	6
Procedura për vlerësimin e performancës në punë	8
Të tjera (sqarime mbi interpretimin/zbatimin e saktë të ligjit; transferimet e përkohshme për nevoja pune; interpretimi i nenit 65/c lidhur me ndërprerjen	23

e punësimit në shërbimin civil për shkaqe ligjore; kërkesa për informacion, etj.)	
TOTAL	68

Lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve administrative për 15 rastet që aktualisht

janë në verifikim nga Komisioneri, situata paraqitet si më poshtë:

Tabela: Mosmarrëveshjet administrative, të klasifikuara sipas objektit të tyre - rastet në proces për vitin 2025

Institucioni i pretenduar për parregullsi sipas kërkesave/informacioneve	Nr. i rasteve
Procedurat disiplinore	1
Procedura për transferim ose largim nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit	2
Procedura për transferim të përkohshëm	3
Procedura e konfirmimit në përfundim të periudhës së provës	2
Procedura e konkurrimit	1
Procedura për vlerësimin e performancës në punë	2
Të tjera (sqarime mbi interpretimin/zbatimin e saktë të ligjit; transferime të përkohshme për nevoja pune; kërkesa për informacion; etj.)	4
TOTAL	15

Lidhur me afatin për trajtimin e informacioneve/kërkesave ose denoncimeve, sipas Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin e Komisionerit nr. 17, datë 11.03.2015, Kreu III “Procedura paraprake”, neni 16 “Verifikimi i informacionit/kërkesës”, pika 4, parashikon sa vijon:

“Afati për trajtimin e informacionit përkatës është në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative (60 ditë). Në varësi të kompleksitetit të rastit, ngarkesës në punë ose

çështjeve të tjera të mundshme të hasura, Komisioneri mund të vendosë, rast pas rasti, zgjatjen e këtij afati. Ky vendim i Komisionerit i komunikohet nëpunësit civil ose personit që ka paraqitur informacionin.”

Nuk ka pasur vonesa në asnjë rast. Ky afat është respektuar në të gjitha rastet e paraqitura pranë Komisionerit, si në ato që janë përmbyllur, ashtu edhe në ato të mbartura në vitin 2025 ose aktualisht në vijim.